



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

PARTNERITETI PËR QEVERISJE TË HAPUR

PLANI KOMBËTAR I VEPRIMIT 2023 - 2025

DHJETOR 2023

Tabela e përmbajtjes

Lista e shkurtesave	3
Hyrje	4
Përpjekjet e mëparshme nën Partneritetin për Qeverisje të Hapur	6
Nisma aktuale e PQH-së	6
Zotimet e Planit të Veprimit të PQH-së në Kosovë	8
1. QEVERISJA DIGJITALE	8
2. TË DHËNAT E HAPURA	12
3. PJESËMARRJA QYTETARE	16
4. KUNDËR-KORRUPSIONI	20

Lista e shkurtesave

AKK –	Agjencia Kundër Korrupsionit
AKPPM –	Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale
BE –	Bashkimi Evropian
AIP –	Agjencia për Informim dhe Privatësi
ASHI –	Agjencia e Shoqërisë së Informacionit
KGJK –	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KPK –	Këshilli Prokurorial i Kosovës
MPB –	Ministria e Punëve të Brendshme
MAP –	Ministria e Administratës Publike
MAPL –	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MSH –	Ministria e Shëndetësisë
AShMDhP –	Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
PKV –	Plani Kombëtar i Veprimit
ODK –	Open Data Kosovo
PQH –	Partneriteti për Qeverisje të Hapur
KRPP –	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
SLAPP –	Proceset Gjyqësore Strategjike Kundër Pjesëmarrjes Publike

Hyrje

Në një shoqëri demokratike, përfshirja e organizatave të shoqërisë civile në proceset qeveritare është me rëndësi jetike.

Procesi i anëtarësimit në PQH konsiderohet si prioritet i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, për faktin se kjo do të vazhdojë t'i hapë rrugën promovimit të qeverisjes së hapur dhe transparente, pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje, gjithëpërfshirjes dhe qeverisjes së përgjegjshme¹.

Në pesë vitet e fundit, Republika e Kosovës ka bërë përmirësime të dukshme në drejtim të dixhitalizimit të shërbimeve dhe hapjes së të dhënave. Kosova ka ofruar një numër të konsiderueshëm e-platformash dhe zgjidhjesh dixhitale, një bazë të fortë ligjore për lirinë e informacionit dhe qasje në dokumentet publike, dhe renditet ndër 50 vendet me shkallën më të lartë të depërtimit të internetit dhe të aftësive dixhitale, si dhe ka një shkallë të lartë të posedimit të telefonave inteligjentë. Për më tepër, Kosova është një nga vendet e pakta e cila zbulon plotësisht pronat, pasurinë, të ardhurat dhe borxhet e rreth 5,000 zyrtarëve publikë të vendit, gjë e cila cilësohet si e arritur.² Përveç kësaj, Republika e Kosovës ka arritur të dizajnojë dhe krijojë platforma të ndryshme digjitale³ duke shënuar progres të dukshëm në fushën e të dhënave të hapura, qeverisjes digjitale dhe pjesëmarrjes qytetare.

Qeveria filloi zbatimin e Iniciativës për Hapjen e të Dhënave në maj të vitit 2016, kur Qeveria e Republikës së Kosovës me vendimin nr. 07/87 miratoi Kartën Ndërkombëtare për Hapjen e të Dhënave. Sipas këtij vendimi, Ministria e Administratës Publike është përgjegjëse për të bashkërenduar zhvillimet dhe punën, si dhe për të promovuar hapjen e të dhënave në Kosovë. Në këtë kuadër është krijuar Portali Kombëtar për të Dhëna të Hapura, në të cilin parashihet publikimi i të dhënave të prodhuara nga Qeveria e Kosovës.

Përmirësimi i shërbimeve publike, ngritja e transparencës, llogaridhënies dhe efikasitetit të administratës publike, si dhe krijimi i një shërbimi civil më profesional janë ndër prioritetet më të rëndësishme që Ministria e Administratës Publike është duke ndërmerr.

Në kontekstin e promovimit të një qeverie të hapur, MAP-i në shtator të vitit 2018 ka lansuar raportin ODRA - Vlerësimi i Gatishmërisë për Hapjen e të Dhënave, bazuar në metodologjinë e Bankës Botërore i cili është përgatitur nga ekspertët vendor dhe ndërkombëtarë, dhe ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse sa i përket gjendjes në Kosovë në fushën e hapjes së të dhënave.

Hapja e të dhënave të qeverisë, parashih ndryshime pozitive në mënyrën se si qeveria ndërvepron me qytetarët. Ky proces u mundëson qytetarëve dhe bizneseve që në mënyrë aktive të marrin vendime të informuara në fusha të ndryshme të veprimtarisë.

Për më tepër, në vitin 2018, Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar Planin e Veprimit për zbatimin e Strategjisë për Modernizimin e Administratës Publike 2015-2020. Qeveria, pas

¹ Inaugurimi i Komitetit Nacional Koordinues në kuadër të Open Government Partnership – OGP (PQH) - <https://bit.ly/3HKRjnK>

² Kosova drejt një Plani të ri Kombëtar të Veprimit për OGP - <https://opendatakosovo.medium.com/kosovo-toëards-a-neë-national-action-plan-for-ogp-d44e2f3fb6a3>

³ Portali për Hapjen e të Dhënave - <https://opendata.rks-gov.net/en/>

E-participimi - <https://eparticipimi.opendatakosovo.org/issues>

E-prokurimi - <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/ClanakItemNeë.aspx>

Platforma e Konsultimeve Publike - <https://konsultimet.rks-gov.net/index.php>

shumë vitesh të udhëheqjes së një procesi kompleks, i cili ishte një ndërthurje e zhvillimit hap pas hapi të strukturave administrative, zhvillimit të kapaciteteve dhe reformave, e vuri fokusin në zhvillimin e kapaciteteve, defragmentimin dhe racionalizimin e proceseve dhe shërbimeve të cilat i ofron administrata për qytetarët dhe përfituesit e tjerë, bazuar në profesionalizmin dhe mos-politizimin brenda shërbimit civil.

Bazuar në praktikën dhe analizat e qasjes së re në Reformën e Administratës, konsiderohet se një menaxhim më efikas i procesit, përpjekjet për eliminimin e barrierave në organizimin dhe zbatimin e reformave si dhe nevoja për t'u fokusuar në rezultate ka kushtëzuar qasjen për ndarjen e fushëveprimit të procesit dhe strukturave të menaxhimit në tre shtylla të Reformës së Administratës Publike.

Strategjia për Modernizimin e Administratës Publike fokusohet në arritjen e rezultateve të synuara në shtyllën e dytë, të cilat kanë të bëjnë me shërbimin civil, menaxhimin e burimeve njerëzore, ofrimin e shërbimeve publike dhe llogaridhënien në administratën publike.⁴

Vendosmëria e qeverisë për të ngritur nivelin e shërbimeve të administratës publike, në shërbime cilësore, të qasshme, të bazuara në procedura të arsyeshme administrative, përmes e-qeverisjes, të orientuara në nevojat e qytetarëve dhe bizneseve, ka rezultuar në iniciimin e zhvillimit të platformës e-Kosova – një mjet për ofrimin online të shërbimeve të administratës publike për qytetarët, bizneset dhe vetë punonjësit e administratës publike. Kjo platformë shërben si sportel elektronik, përmes të cilit çdo i interesuar përmes internetit mund të marrë shërbimet elektronike të ofruara nga institucionet publike në Kosovë, duke shkurtuar distancën, si dhe duke rritur efikasitetin dhe shpejtësinë e shërbimit. Platforma menaxhohet dhe administrohet nga Agjencia e Shoqërisë së Informacionit dhe është e ndërlidhur me Platformën e Ndërveprimit, e cila është arkitektura bazë në të cilën mundësohet ndërveprimi i regjistrave elektronikë të institucioneve të Kosovës.⁵

Sa i përket të drejtës për qasje në dokumente publike, Kuvendi i Kosovës në vitin 2019 miratoi një ligj të ri që i garanton publikut të gjerë të drejtën për qasje në dokumente, duke shfuqizuar kështu ligjin e mëparshëm të quajtur Ligji për Qasje në Dokumente Zyrtare. Legjislacioni i miratuar rishtazi ka vendosur për emërimin e Komisionerit - një organ i pavarur përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit. Pas një procedure të gjatë dhe komplekse përzgjedhjeje, Komisionerja është emëruar nga Parlamenti. Ajo funksionon në kuadër të Agjencisë për Informim dhe Privatësi (IPA)⁶ e njohur më parë si Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Për më tepër, sipas Indeksit më të fundit të Perceptimit të Korrupsionit të Transparency International për vitin 2021⁷, Republika e Kosovës gjatë vitit të kaluar ka shënuar progres në luftën kundër korrupsionit. Ajo i jep Kosovës 39 nga 100 pikë të mundshme, tre më shumë se pikët e saj në vitin 2020.⁸ Pavarësisht këtij zhvillimi pozitiv të shënuar, vendi duhet të forcojë

⁴ Modernizimi i Administratës Publike në Republikën e Kosovës - <http://ëëë.adjuris.ro/revista/articole/an7nr2/2.%20Avdullah%20Robaj.pdf>

⁵ Platforma E-Kosova - <https://ekosova.rks-gov.net/#>

⁶ Agjencia për Informim dhe Privatësi - <https://aip.rks-gov.net/en/aip-english/>

⁷ Indeksi i perceptimit të korrupsionit, Transparency International <https://ëëë.transparency.org/en/cpi/2021/index/ksv>

⁸ Ngritja e Kosovës në Indeksin e perceptimit të korrupsionit e mirëpritur, Pristina Insight - <https://prishtinainsight.com/kosovos-rise-in-transparencys-corruption-index-ëelcomed/>

sundimin e ligjit dhe të vazhdojë luftën kundër korrupsionit përmes mekanizmave ligjorë dhe institucionale.

Përpjekjet e mëparshme nën Partneritetin për Qeverisje të Hapur

Qeveria e Kosovës në vitin 2013 miratoi një vendim për fillimin e procedurave për anëtarësim në Partneritetin për Qeverisje të Hapur, gjë e cila cili shënoi hapat e parë drejt anëtarësimit në PQH në cilësinë e shtetit anëtar. Me këtë vendim, Qeverisë së Kosovës i është kërkuar që të respektojë të gjitha obligimet që rrjedhin nga procesi edhe pas anëtarësimit të Republikës së Kosovës në PQH.

Qeveria arriti të hartojë Planin Kombëtar të Veprimit 2014-2016 dhe të gjitha kriteret dhe kushtet e PQH-së janë përmbushur. PKV-ja synonte adresimin e sfidave që lidhen me qeverisjen e hapur si a) Përmirësimi i shërbimeve publike, b) rritja e integritetit publik, c) menaxhimi efektiv i burimeve publike dhe d) rritja e llogaridhënies së korporatave. Ndër të tjera, PKV-ja theksoi se të gjitha ligjet e miratuara ishin në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira të vendeve të Bashkimit Evropian si dhe në përputhje të plotë me kriteret e *acquis communautaire*. Gjithashtu, në atë kohë janë caktuar detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve publike përkatëse. Fatkeqësisht, rrugëtimi drejt anëtarësimit në PQH nuk mundi të materializohej në vitin 2013. Përkundër kësaj, Qeveria e Republikës së Kosovës ka treguar vazhdimisht përkushtim serioz për angazhimin, përmbushjen dhe arritjen e parimeve të PQH-së, siç edhe theksohet në pjesën hyrëse. Qeveria vazhdon përpjekjet dhe angazhimet e saj për parimet e qeverisjes së hapur dhe të përgjegjshme, duke bërë kështu lëvizje progresive në fushën e kornizës ligjore dhe institucionale. Prandaj, në qershor të vitit 2021 Qeveria e Kosovës edhe një herë vendosi të fillojë nismën për anëtarësim në PQH.

Nisma aktuale e PQH-së

Në mbledhjen e zhvilluar me datë 08 qershor 2021, Qeveria e Republikës së Kosovës miraton propozimin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal - MAPL për anëtarësim në organizatën ndërkombëtare Open Government Partnership – OGP⁹.

Në bazë të këtij vendimi MAPL ka themeluar Komitetin Nacional Koordinues për hartimin e Planit Kombëtar të Veprimit 2023-2025, i përbërë nga institucionet publike, shoqëria civile si shumicë, sektori i biznesit dhe aketerë tjerë relevant. Komiteti Nacional Koordinues është drejtuar nga një udhëheqës i lartë nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe një udhëheqës nga përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile.

⁹ <https://ëëë.opengovpartnership.org/about/>

Gjatë tetorit 2021 është inauguruar Komiteti Nacional Koordinues për PQH Kosova – një komitet i përbërë nga institucionet publike, shoqëria civile, organizatat dhe institucionet tjera relevante.¹⁰

Për të mbledhur të dhëna kuptimplota nga akterët profesionistë, duke përfshirë organizatat e shoqërisë civile, institucionet lokale dhe qendrore si dhe sektori privat, Komiteti Nacional Koordinues ka zhvilluar një seri debatesh publike¹¹ dhe takime me palët e interesit në emër të Komitetit Nacional Koordinues për PQH Kosova. Si rezultat i ngjarjeve të tilla, informatat kthyesë të mbledhura janë pasqyruar në katër angazhime të Qeverisë, të cilat konsistojnë në qeverisjen dixhitale, të dhënat e hapura, pjesëmarrjen e qytetarëve dhe kundër-korrupsionin.

Ky Komitet ka zhvilluar 12 takime pune, 7 diskutime publike në 7 rajonet e Kosovës, 4 punëtori tematike dhe ka hartuar Planin Kombëtar të Veprimit 2023-2025. Plani Kombëtar i Veprimit 2023-2025 është publikuar për konsultim publik për 60 ditë duke i dhënë mundësi çdo qytetari të Republikës së Kosovës për komente, ku komentet e marra janë përfshirë në plan. Gjithashtu Plani Kombëtar i Veprimit 2023-2025 është dërguar për konsultim edhe në Open Government Partnership Support Unit, ku komentet e marra janë adresuar në këtë plan.

Janë organizuar debate publike në komunat kryesore të Kosovës, veçanërisht në Prishtinë, Prizren, Pejë, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë Jugore dhe Gjakovë, për t'u konsultuar me përfaqësuesit e institucioneve kyçe shtetërore, OJQ-të dhe qytetarët e secilës komunë përkatëse për angazhimet kryesore të përmendura më lartë. Ndërsa, takimet e palëve të interesit u organizuan për të mbledhur të dhëna specifike nga institucionet kryesore publike, OSHC-të, bizneset dhe mediat, për të diskutuar sfidat, sukseset dhe për të dhënë rekomandime konkrete.

Ngjarjet e tilla ofruan një rol të rëndësishëm gjatë procesit të përcaktimit të çështjeve dhe angazhimeve thelbësore. Ngjarjet në mënyrë rigoroze ndoqën metodologjinë e punës sipas Manualit Kombëtar të PQH-së.

1. Qeverisja Dixhitale
<ul style="list-style-type: none">• Zhvillimi dhe promovoni i një ueb portali të centralizuar të shërbimeve elektronike për Kosovën (eKosova)
<ul style="list-style-type: none">• Integrimi i modulit të ri (eKomunat) në kuadër të eKosova me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes qytetare dhe efikasitetit të shërbimeve komunale
<ul style="list-style-type: none">• Zhvillimi i një sistemi online për raportimin dhe vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore
2. Të dhënat e hapura
<ul style="list-style-type: none">• Përmirësimi i procedurave të brendshme brenda institucioneve për publikimin e të dhënave qeveritare dhe vënien e tyre në dispozicion në faqet e internetit të institucionit / Portali i të Dhënave të Hapura

¹⁰ <https://ogpkosova.org/neës2>

¹¹ <https://ogpkosova.org/neës4>

<ul style="list-style-type: none"> • Rritja e numrit të bazës së të dhënave të publikuara në Portalin e të Dhënave të Hapura me 30%
<ul style="list-style-type: none"> • Ofrimi i ndihmës (teknike) për zyrtarët publikë të ngarkuar me publikimin e të dhënave publike
<ul style="list-style-type: none"> • Rritja e ndërgjegjësimit të akterëve përkatës për rëndësinë e të dhënave të hapura
3. Pjesëmarrja qytetare
<ul style="list-style-type: none"> • Përmirësimi i platformave ekzistuese për pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse duke ofruar asistencë teknike dhe ngritjen e kapaciteteve për zyrtarët publikë
<ul style="list-style-type: none"> • Mbështetja e nismave të shoqërisë civile në ngritjen e vetëdijes përmes fushatave për të parandaluar përhapjen e proceseve gjyqësore strategjike kundër pjesëmarrjes publike (SLAPP).
<ul style="list-style-type: none"> • Vendosja ose përmirësimi i mekanizmave për ankesat e qytetarëve në lidhje me shërbimet e institucioneve publike
4. Kundër-korrupsioni
<ul style="list-style-type: none"> • Sistem plotësisht i hapur i prokurimit publik
<ul style="list-style-type: none"> • Rritja e transparencës së institucioneve të rekrutimit për postet e larta shtetërore

Zotimet e Planit të Veprimit të PQH-së në Kosovë

1. QEVERISJA DIGJITALE

Zotimi 1: Avancimi dhe promovimi i ueb portalit të centralizuar të shërbimeve elektronike për Kosovën (eKosova)	
01/01/2024 – 31/12/2025	
Cili është problemi i adresuar nga ky zotim?	<p>Me qëllim arritjen e barazie në trajtim, qasjes së lehtë në informata dhe aplikim, vlerësim të drejt dhe profesional, menaxhim cilësor, impakt në zhvillimin ekonomik dhe me qëllim rritjen e transparencës dhe zvogëlimin të mundësive për keq-përdorime dhe afere korruptive Qeveria e Kosovës që brenda një viti ndan rreth 300 milionë euro grante dhe subvencione për individ, biznese dhe organizata jo-qeveritare, do të zhvillojë një seksion të veçantë në kuadër të Platformës Shtetërore E-KOSOVA me qëllim digjitalizimin e proceseve për dhënien e granteve dhe subvencioneve.</p> <p>Në kuadër të këtij seksioni do të përfshihen:</p> <ol style="list-style-type: none">1. Publikimi i thirrjeve për grante dhe subvencione nga të gjitha institucionet publike në Republikën e Kosovës.2. Publikimi i kriterëve dhe procedurave për aplikim. Duke përfshirë edhe afatet kohore.3. Publikimi i formularit online dhe aplikimi online për grante dhe subvencione;4. Ofrimi i asistencës 24/7 për aplikantët në procesin e aplikimit.5. Publikimi i përfituesve nga çdo thirrje duke përfshirë, publikimi i projekteve të tyre, oferta financiare dhe afati kohor i zbatimit.6. Publikimi raporteve individuale të vlerësimit të përfituesve dhe jo-përfituesve nga ana e komisioneve vlerësuese;7. Mundësia e ankesës dhe trajtimi online i ankesave;8. Publikimi i rregullt i raporteve të vlerësimit të përfituesve nga komisionet për mbikëqyrjen e zbatimit të granteve dhe subvencioneve qeveritare. Duke përfshirë impaktin, arritjen e qëllimeve dhe objektivave, realizmin e aktiviteteve dhe menaxhimin e financiar.9. Secili qytetarë i Republikës së Kosovës dhe çdo palë e interesuar do të ketë qasje në tërë procesin dhënies së granteve dhe

	<p>subvencioneve nga ana e institucioneve publike.</p> <p>Në kuadër të platformës eKosova, tashmë është themeluar Pika e Vetme e Kontaktit (PVK) për licencimin e auditorëve dhe kompanive të auditimit dhe duke zgjeruar gradualisht dhe në vazhdimësi shërbimet e PVK-së në sektorë të tjerë, Qeveria do t'u mundësojë qytetarëve të saj, bizneseve dhe të tjerëve që të kryejnë të gjitha procedurat administrative online.</p>
<p>Cili është zotimi?</p>	<p>Për të siguruar një proces të qëndrueshëm dhe efektiv, Qeveria do të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - dixhitalizojë procesin e aplikimit për grante dhe subvencione; përmes PVK-së të dixhitalizojë të gjithë hapat e nevojshëm administrativë për marrjen e lejeve, licencave ose regjistrimeve - trajtojë zyrtarët publikë se si të trajtojnë aplikacionet dixhitale; - forcojë, përditësojë dhe mirëmbajë portalin shtetëror ekzistues me informacione përkatëse që do të theksonin transparencën; - krijojë një listë të aplikuarve e cila do të paraqisnin të dhënat e mëparshme të aplikuesve, d.m.th. OJQ-të. Konkretisht, kjo do të ilustrojë OJQ-të të cilat kanë fituar më parë, ato që nuk ishin të përgjegjshme ndaj proceseve të raportimit dhe anasjelltas; - ndërlidhë dhe koordinojë dokumentacionin ndërmjet institucioneve. Për shembull, Administrata Tatimore me Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës, për të reduktuar komplikimet dhe kostot në nxjerrjen e dokumentacionit përkatës dhe transferimin nga një institucion në tjetrin. - Aplikim online për lëshimin e licencave dhe lejeve të veprimtarisë për import/eksport të produkteve dhe pajisjeve medicinale.
<p>Si kontribuon zotimi në zgjidhjen e problemit të identifikuar?</p>	<p>Procesi i dixhitalizuar do të mundësojë formularë aplikimi lehtësisht të qasshëm për të gjithë përfituesit e mundshëm të granteve dhe subvencioneve publike. Zyrtarët publikë do të krijojnë kapacitete për trajtimin e duhur</p>

	të aplikimeve online dhe të gjitha dokumentet e ofruara nga aplikuesit do të regjistrohen në një portal shtetëror i cili mundëson një bazë të dhënash të të gjitha informacioneve, përfshirë cilësinë e punës dhe performancën e aplikuesve në të kaluarën.
Pse është i rëndësishëm zotimi për vlerat e PQH-së?	Zotimi është i rëndësishëm për transparencën, eliminimin e keq-përdorimeve dhe korrupsionit dhe ofrimin e mundësive të barabarta për të gjithë.
Informacione shtese	Janë iniciuar disa hapa drejt heqjes së barrës administrative në kuadër të procesit të aplikimit për grante dhe subvencione, duke synuar kalimin e të gjithë procesit në formatet dixhitale. Për shembull, në vitin 2021, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë i ka mundësuar bizneseve që përmes eKosova të aplikojë online për grante dhe subvencione.
Përshkrimi i rezultateve të pritura	Mundësia e aplikimeve, vlerësimeve dhe zbatimit të projekteve nga individ, OJQ dhe biznese online për grante dhe subvencione do të mundësohet përmes portalit shtetëror e-Kosova.

Nr.	Arrijet	Indikatorët	Bartësi i aktivitetit	Data e fillimit	Data e përfundimit
1.	Qeveria e Republikës së Kosovës harton dhe miraton Udhëzim Administrativ për procesin e digjitalizimit të dhënies së granteve dhe subvencioneve.	Bazë ligjore për krijimin e seksionit për aplikim për grante dhe subvencione.	Zyra ligjore në kuadër të zyrës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.	01/01/2024	30/06/2024
2.	Agjencia e Shoqërisë së Informacionit (ASHI) ndërmerr krijimin e një seksioni përkatës për aplikimet online për grante në platformën e-Kosova.	Numri i mjeteve teknike të dizajnuara, përgatitura dhe të përfshira në platformën e-Kosova.	ASHI, MPB	01/06/2024	30/12/2025

3.	Zyrtarët publikë janë më të vetëdijshëm për rëndësinë e aplikacioneve online dhe kanë njohuri të zgjeruara se si të trajtojnë aplikacionet e tilla.	Numri i zyrtarëve publikë të trajnuar	Zyra e Kryeministrit /Zyra për Qeverisje të Mirë/ Agjencia e Shoqërisë së Informacionit (ASHI)	01/06/2024 4	01/08/2024 4
----	-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	---------------------------------------	------------------------------------------------------------------------------------------------	-----------------	-----------------

Zotimi 2: Integrimi i modulit të ri (eKomunat) në kuadër të eKosova me qëllim digjitalizimin e të gjitha shërbimeve komunale, rritjes së pjesëmarrjes qytetare dhe efikasitetit të shërbimeve komunale

01/01/2024 – 31/12/2025

Cili është problemi i adresuar nga ky zotim?

Digjitalizimi i 50 shërbimeve komunale në portalin shtetëror qendror eKosova përmes platformës eKomunat do të jetë një vlerë e shtuar në lehtësimin e kryerjes së shërbimeve komunale për qytetarët. Kjo do të reduktoje ndjeshëm nevojën për prezencë fizike në komuna.

Cili është zotimi?

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në vazhdim të reformave të filluara sa i përket pushtetit lokal ka për synim që brenda një afati optimal kohor të fillojë procesin e digjitalizimit të shërbimeve dhe aktiviteteve komunale.

Kjo platformë do të jetë në shërbim të qytetarëve për rritur pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje në nivelin lokal, gjithashtu do të jetë në shërbim të vet komunave për digjitalizimin e shërbimeve komunale duke rritur efikasitetin e këtyre shërbimeve karshi qytetarëve.

Duke pas parasysh gamën e shërbimeve që do të ofrojë platforma E-KOMUNAT, ajo do të jetë platformë interoperabile me të gjitha platformat ekzistente që operojnë në shërbimin publik. Kjo platformë do të përfshijë shërbimet e 38 komunave të Republikës së Kosovës, duke ofruar shërbimet në gjuhët zyrtare në vendin tonë.

Si kontribuon zotimi në zgjidhjen e problemit të identifikuar?

Qëllim i këtij seksioni është krijimi i hapësirës për procese transparente, llogaridhënies, të rrisë pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse dhe të përmirësojë dhe rrisë efikasitetin e shërbimeve në nivelin lokal. Fokusi i monitorimit të këtij programi janë dy nivelet organeve komunale sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale pra Kuvendet Komunale dhe Ekzekutivi i Komunave.

Pse është i rëndësishëm zotimi për vlerat e PQH-së?	Nëpërmjet ofrimit të një shërbimi të tillë do të bëhet i mundur promovimi i teknologjive të reja si dhe do të jetë evidente ulja e kostos së përdorimit të këtyre teknologjive. Kjo është thelbësore për fuqizimin socio-ekonomik të qytetarëve që banojnë jashtë zonave urbane.
Përshkrimi i rezultateve të pritura	Qytetarët dhe bizneset nga zona të ndryshme të vendit do të mund të kryejnë shërbime të ndryshme komunale. Për më tepër, pasi platforma do të fokusohet në monitorimin e organeve komunale do të ndikoj në rritjen e pjesëmarrjes qytetare, pra rritjen e ndërveprimit qytetarë dhe përfaqësues komunal. Përmes këtij moduli qytetarët do të kenë qasje në kohë reale të buxhetit dhe të hyrat vetanake komunale, të dhënat e hapura dhe interaktive, kontraktimi i hapur, planet urbanistike të lagjeve, lejet dhe kushtet ndërtimore, prezantimi i procesit të vlerësimit të ligjshmërisë së akteve komunale dhe shumë shërbime të tjera.

Nr	Arritjet	Indikatorët	Bartësi i aktivitetit	Data e fillimit	Data e përfundimit
1.	Është zhvilluar koncepti i dokumentit për platformën e-Komunat	Takimet e grupit këshillues	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), 38 komuna, Agjencia e Shoqërisë së Informacionit.	01/01/2024	01/03/2024
2.	Procesi i hapur i kontraktimit të kompanisë për zhvillimin e platformës	Lidhja e kontratës me sukses dhe brenda afatit kohor	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Agjencia e Shoqërisë së Informacionit, Komunat.	01/04/2024	01/07/2024
3.	Zhvillimi i platformës dhe funksionalizimit të shërbimeve të reja digjitale	Integrimi i eKomunave në eKosova	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Agjencia e Shoqërisë së Informacionit, Komunat.	01/07/2024	31/12/2024
4.	Vlerësimi i aftësive/nevojave të zyrtarëve publikë në përfshirjen e	Numri i zyrtarëve publikë që kanë nevojë	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL),	01/01/2025	31/04/2025

	platformës eKomunat në punën e tyre	për ndihmë teknike	Agjencia e Shoqërisë së Informacionit, Komunat.		
5.	Trajnimi dhe ngritja e kapaciteteve të stafit komunal në përdorimin e platformës eKomunat	Numri i trajnimeve dhe zyrtarë të trajnuar	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Agjencia e Shoqërisë së Informacionit, Komunat.	01/05/2025	31/08/2025

Zotimi 3: Zhvillimi i një sistemi online për raportimin dhe vlerësimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore

01/01/2024 - 31/12/2024

Cili është problemi i adresuar nga ky zotim?	Ky angazhim mundëson qasje të barabartë për të gjithë qytetarët për të identifikuar dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore. Në këto raste, komisionet e vlerësimit të dëmeve shpesh vonohen në punën e tyre në terren, duke lënë hapësirë për manipulime nga palët e prekura. Në këtë mënyrë të gjithë ata që pretendojnë se janë dëmtuar mund ta bëjnë këtë online.
Cili është zotimi?	Dizajnimi dhe krijimi i aplikacionit për regjistrimin dhe evidentimin e dëmeve nga fatkeqësitë natyrore i dedikuar qytetarëve, me theks të veçantë fermerëve të cilët mund ta përdorin për këtë qëllim këtë aplikacion online.
Si kontribuon zotimi në zgjidhjen e problemit të identifikuar?	Sistemi i raportimit dhe vlerësimit online do të ndihmonte shumë në kompensimin e drejtë për të gjithë.
Pse është i rëndësishëm zotimi për vlerat e PQH-së?	Ai mbështet aftësinë e qeverisë dhe shoqërisë dhe komunitetit të biznesit për të përdorur teknologjinë për të mirën e përbashkët.
Përshkrimi i rezultateve të pritura	Regjistrimi/raportimi online i aplikacioneve të dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore do të jetë i disponueshëm përmes një aplikimi online.

Nr.	Arritjet	Indikatorët	Bartësi i aktivitetit	Data e fillimit	Data e përfundimit
1.	Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe komunave për dixhitalizimin e identifikimit të dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore.	Numri i raporteve të marra përmes aplikacionit online.	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	01/01/2024	Ongoing

	Një marrëveshje e tillë parasheh që komisionet komunale dhe ministrot për verifikimin dhe kompensimin e dëmit të pranojnë fillimisht raportet online dhe më pas të vazhdojnë me verifikimet në terren.				
2.	Është inicuar thirrja për ofrimin e ekspertizës teknike për krijimin e një formulari aplikimi online	Numri i aplikimeve të pranuar	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	01/02/2024	31/07/2024
3.	Formati i aplikimit online po përdoret nga qytetarët dhe komuniteti i biznesit	Numri i raporteve të dërguara online	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Komunitat	01/08/2024	Ongoing

2. TË DHËNAT E HAPURA

Zotimi 1: Përmirësimi i procedurave të brendshme brenda institucioneve për publikimin e të dhënave qeveritare dhe vënien e tyre në dispozicion në faqet e internetit të institucionit / Portali i të Dhënave të Hapura	
01/01/2024 - 31/12/2025	
Cili është problemi i adresuar nga ky zotim?	<p>Republika e Kosovës është e përkushtuar ndaj parimeve të qeverisjes së hapur dhe llogaridhënese dhe në kuadër të përpjekjeve të saj për të rrit transparencën, për të përmirësuar kualitetin e shërbimeve publike dhe për të rrit menaxhimin efektiv të burimeve publike më datën 13.05.2016 miratoi Kartën për Hapjen e të Dhënave në Republikën e Kosovës. Me këtë vendim, Qeveria e Kosovës obligoi Ministrinë e administratës publike të koordinojë dhe zbatojë aktivitetet e nevojshme që rrjedhin nga parimet e Kartës. Miratimi i Kartës për hapjen e të dhënave është në përputhje me iniciativën e Partneritetit për Qeverisje të Hapur (PQH), ku Republika e Kosovës synon të anëtarësohet dhe tregues i përkushtimit të Qeverisë së Kosovës për qeverisje transparente, llogaridhënese dhe të përgjegjshme.</p> <p>Dokumentet dhe të dhënat e prodhuara nga institucionet publike përbëjnë një grumbullim të madh e shumë të rëndësishëm të informatave, që do të mund të ndihmojnë ekonominë.</p> <p>Hapja e të dhënave, në parim me Direktivën 2013/37/EU të Parlamentit dhe Këshillit</p>

	Evropian për ripërdorimin e informatave të sektorit publik, do të mundësonte shtimin e vlerës së këtyre informatave dhe të dhënave për të gjithë përdoruesit dhe shoqërinë në përgjithësi.
Cili është zotimi?	<p>Transparenca - Të dhënat e hapura përkrahin mbikëqyrjen publike të qeverive dhe ndihmojnë në uljen e korrupsionit duke mundësuar transparencë më të madhe. Të dhënat e hapura, gjithashtu inkurajojnë pjesëmarrjen më të madhe qytetarëve në çështjet e qeverisë dhe qeverisjes.</p> <p>Përmirësim të shërbimeve publike - Të dhënat e hapura ju sigurojnë qytetarëve materialet e dorës së parë - të papërpunuara që ju nevojiten për t'i shtyrë në angazhim qeveritë e tyre, dhe të kontribuojnë në përmirësimin e shërbimeve publike. Për shembull, qytetarët mund të përdorin të dhëna të hapura për të kontribuar në planifikimin publik, ose të sigurojnë reagime dhe përgjigje për ministritë, në lidhje me cilësinë e shërbimit.</p> <p>Inovacioni dhe vlera ekonomike - Të dhënat publike, dhe ri-përdorimi i tyre, janë burime kyçe për inovacion social dhe rritje ekonomike. Të dhënat e hapura ofrojnë mundësi të reja të bashkëpunimit mes qeverive dhe qytetarëve dhe për vlerësimin e shërbimeve publike, duke u dhënë qasje qytetarëve në të dhënat në lidhje me këto shërbime. Bizneset dhe sipërmarrësit janë duke përdorur të dhënat e hapura për të kuptuar më mirë tregjet potenciale dhe për të ndërtuar produkte të reja të bazuara në të dhëna.</p> <p>Efikasitet - Të dhënat e hapura e bëjnë më të lehtë dhe më pak të kushtueshme për ministritë e Qeverisë, zbulimin dhe qasjen në të dhënat e tyre apo të dhënat nga ministritë e tjera, gjë që e zvogëlon koston e blerjes, redundancën dhe overhead-in. Të dhënat e hapura mund t'ia mbjellin qytetarëve aftësinë për të njoftuar qeveritë në lidhje me boshllëqet ekzistuese në të dhënat publike, për të dhënë informacion më të saktë.</p>
Si kontribuon zotimi në zgjidhjen e problemit të identifikuar?	Duke pasur procedura të brendshme, që sigurojnë një bazë të dhënash plotësisht të qasshme në Portalin e të Dhënave të Hapura, do të nxis ministritë/departamentet përkatëse të ngarkojnë dhe ndajnë bazën e të dhënave të tyre publike.
Pse është i rëndësishëm zotimi për vlerat e PQH-së?	Ky zotim do të kontribuojë në transparencën e punës së institucionit, si dhe do të lehtësojë

	<p>procesin e punës së atyre që ndajnë fokusin në të dhënat përkatëse (autoritetet qeveritare apo joqeveritare).</p> <p>Kuadri ligjor që siguron qasje në të dhënat publike, duhet gjithashtu të konsiderojë publikimin e bazës së të dhënave si të përpunueshme nga makina (machine-processable/format i lexueshëm) dhe gjithashtu të jetë i plotë për sa i përket detajeve të informacionit.</p>
Përshkrimi i rezultateve të pritura	<p>1. Të shfrytëzohet revolucioni i teknologjisë dhe i të dhënave për të shtyrë përpara vizionin nacional dhe prioritetet zhvillimore të Kosovës nëpërmjet institucioneve dhe strukturave ekzistues;</p> <p>2. Karta për Hapjen e të Dhënave dhe ky plan i veprimit të bëhet pjesë komplementare e strategjive dhe politikave ekzistuese nacionale dhe lokale për rritje të transparencës dhe llogaridhënies.</p>

Nr.	Arritjet	Indikatorët	Bartësi i aktivitetit	Data e fillimit	Data e përfundimit
1.	Formimi i Këshillit Strategjik Nacional për monitorimin dhe drejtimin e implementimit të Kartës për Hapjen e të dhënave në Republikën e Kosovës.	Numri i bazës së të dhënave të publikuara	Të gjitha institucionet publike dhe shoqëria civile.	01/01/2024	31/03/2024
2.	Formimi i Grupit punues ndërinstytucional për implementimin e Kartës për Hapjen e të Dhënave në Republikën e Kosovës.	Përgatitja e inventarit të të dhënave	<ul style="list-style-type: none"> •Udhëheqës të arkivave nëpër ministri •Udhëheqës të sektorëve për IT nëpër institucionet e qeverisë • Përfaqësues i Drejtorisë për mbrojtjen e të dhënave personale •Përfaqësues i komunave •Agjencia e Kosovës Kundër Korrupsionit •Zyra për Qeverisje të Mirë 	01/01/2024	31/08/2024

			• OJQ		
3.	Përcaktimi i afatit për ministritë/departamente t për të publikuar të dhënat përkatëse	Numri i institucioneve që publikojnë në mënyrë proaktive bazat e të dhënave	Të gjitha institucionet publike	01/01/2024	31/12/2024

Zotimi 2: Rritja e numrit të grupeve të të dhënave të publikuara në Portalin e të Dhënave të Hapura me 30%

01/01/2025 - 31/12/2025

Cili është problemi i adresuar nga ky zotim?	Portali qendror do të lehtësoj shpërndarjen e të dhënave të hapura, duke mundësuar qasje dhe kërkim të lehtë të grupeve të ndryshme të të dhënave të hapura. Format i të dhënave të vëna në portal duhet të jetë në pajtim me standardet e hapura. Njëkohësisht, ky portal në të ardhmen mund të siguroje dokumentacion për mënyrën e përdorimit të të dhënave. Për lehtësimin e gjetjes së tyre ky portal duhet të lejoj motorët e kërkimit (si Google) të bëjnë indeksimin e të dhënave.
Cili është zotimi?	Ai synon të ngarkojë në këtë portal baza të të dhënave të rëndësishme në mënyrë që të dhënat të jenë të qasshme për të gjithë akterët e rëndësishëm.
Si kontribuon zotimi në zgjidhjen e problemit të identifikuar?	Duke pasur të dhëna të qasshme të ngarkuara në portalin publik, të gjitha palët e interesit do të përfitojnë nga bazat e të dhënave të gatshme për përdorim. Kjo gjithashtu do të kursejë kohë dhe do të kontribuojë në informacionin e saktë.
Pse është i rëndësishëm zotimi për vlerat e PQH-së?	Zotimi do të kontribuojë në transparencën e punës së institucionit, si dhe do të informojë qytetarët e vendit në aspekte të caktuara.
Përshkrimi i rezultateve të pritura	Rezultati i pritur i referohet një portali të përditësuar dhe të qasshëm që shfaq të dhënat publike. Një informacion i tillë kyç që paraqet interesin e çdo qytetari (autoriteteve të ndryshme qeveritare dhe joqeveritare) duhet të jetë i qasshëm për të gjithë. Në këtë mënyrë qytetarët mund të informohen në përputhje me rrethanat, dhe puna e institucionit mbetet transparente.

Nr.	Arritjet	Indikatorët	Bartësi i aktivitetit	Data e fillimit	Data e përfundimit
1.	Institucionet publike do të identifikojnë bazat e të dhënave që mungojnë në portal	Numri i bazave të të dhënave që mungojnë	Ministria e Punëve të Brendshme / Administratë s Publike	01/01/2025	31/06/2025

2.	Përcaktimi i prioriteteve për publikimin e të dhënave në të gjitha institucionet publike.	Lista e prioriteteve të grupeve të të dhënave	Të gjitha institucionet publike	01/07/2025 5	31/08/2025
2.	Procesi i ngarkimit të bazave të të dhënave që mungojnë në portal është nisur dhe ka përfunduar	Numri i bazave të të dhënave të publikuara	Ministria e Punëve të Brendshme / Administratë s Publike	01/08/2025 5	31/12/2025

Zotimi 3: Ofrimi i ndihmës (teknike) për zyrtarët publikë të ngarkuar me publikimin e të dhënave publike

01/08/2025 - 31/08/2025	
Cili është problemi i adresuar nga ky zotim?	Zyrtarët publikë mund të kërkojnë gjithashtu ndihmë shtesë për të qenë në gjendje të publikojnë të gjitha bazat e të dhënave përkatëse në Portalin e të Dhënave të Hapura si një platformë institucionale.
Cili është zotimi?	Rritja e të kuptuarit si dhe e kapaciteteve të zyrtarëve publikë që janë të ngarkuar me publikimin e bazave të të dhënave për publikun.
Si kontribuon zotimi në zgjidhjen e problemit të identifikuar?	Ndihma e dhënë do të rrisë aftësitë e zyrtarëve publikë dhe do ta bëjë më efikas procesin e publikimit të bazave të të dhënave.
Pse është i rëndësishëm zotimi për vlerat e PQH-së?	Procesi i publikimit të bazave të të dhënave do të kontribuojë në përmbushjen e dy angazhimeve të mëparshme.
Përshkrimi i rezultateve të pritura	Rezultati i pritur është që të ketë personel të pajisur mirë që është përgjegjës për publikimin e bazave të të dhënave në një portal publik.

Zotimi 4: Rritja e ndërgjegjësimit të akterëve përkatës për rëndësinë e të dhënave të hapura

01/01/2024 - 31/12/2025	
Cili është problemi i adresuar nga ky zotim?	Shumica e institucioneve publike si dhe palët e tjera të interesit nuk kanë informacion apo njohuri kyçe për rëndësinë e të dhënave të hapura. Përmes këtij zotimi, Qeveria synon të ndërgjegjësojë të gjithë akterët relevantë në këtë fushë.
Cili është zotimi?	Njohuritë e përgjithshme dhe specifike të nëpunësve civilë dhe palëve të tjera të interesit mbi të dhënat e hapura janë përmirësuar.
Si kontribuon zotimi në zgjidhjen e problemit të identifikuar?	Ndërgjegjësimi i rritur do të përmirësonte procesin e të dhënave të hapura. Kjo do të stimulonte gjithashtu presionin nga publiku i gjerë për arritje më të mira në fushën e të

	dhënave të hapura si dhe zbulimin proaktiv të informacionit/dokumenteve publike.
Pse është i rëndësishëm zotimi për vlerat e PQH-së?	Zotimi kontribuon për një Qeveri më të hapur dhe transparente
Përshkrimi i rezultateve të pritura	Fushata ndërgjegjësuere për popullarizimin e të dhënave të hapura midis palëve të interesit.

Nr.	Arritjet	Indikatorët	Bartësi i aktivitetit	Data e fillimit	Data e përfundimit
1.	Një mori ngjarjesh mbi të dhënat e hapura janë organizuar me sukses	Numri i pjesëmarrësve të përfshirë në ngjarjet e ndërgjegjësimit	Zyra e Kryeministrit	01/01/2024	01/12/2024
2.	Është rritur përqindja e informacionit dhe dokumenteve të publikuara në mënyrë proaktive	Numri i institucioneve që publikuan në mënyrë proaktive dokumente dhe informacione zyrtare	Zyra e Kryeministrit	01/04/2024	31/12/2024
3.	Broshura dhe forma të tjera të informimit mbi rëndësinë e të dhënave të hapura konceptohen, hartohen dhe shpërndahen tek qytetarët.	Numri i broshurave të shpërndara	Zyra e Kryeministrit	01/01/2025	31/12/2025

3. PJESËMARRJA QYTETARE

Zotimi 1: Përmirësimi i platformave ekzistuese për pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse duke ofruar asistencë teknike dhe ngritjen e kapaciteteve për zyrtarët publikë	
01/01/2024 – 31/12/2024	
Cili është problemi i adresuar nga ky zotim?	Pjesëmarrja qytetare nënkupton një veprim individual ose kolektiv, me qëllim të identifikimit dhe adresimit të çështjeve me interes publik. Pjesëmarrja qytetare është një proces ku qytetarët organizojnë veten dhe qëllimet e tyre në nivelin praktik dhe punojnë së bashku qoftë në nivel individual ose përmes organizatave të shoqërisë civile për të ndikuar në procesin e vendimmarrjes. Pjesëmarrja në procese vendimmarrëse do të thotë mundësi për qytetarët, OShC-të dhe palët e tjera të interesuara për të ndikuar në zhvillimin e politikave dhe ligjeve të cilat i prekin ata.

Pjesëmarrja qytetare nuk i pezullon kompetencat kushtetuese dhe ligjore të përfaqësuesve të pushtetit ekzekutiv dhe legjislativ në procedurën e miratimit dhe zbatimit të ligjeve, si dhe të instrumenteve të politikave publike, por për më tepër ua mundëson autoriteteve t'i zbatojnë këto kompetenca në mënyrë më efikase.

Ekzistojnë katër nivele të pjesëmarrjes qytetare, nga ai me më së paku pjesëmarrje deri tek ai me pjesëmarrësi. Këto janë: informimi; konsultimi; dialogu dhe partneriteti.

Qasja në informata është baza e të gjithë hapave pasues në përfshirjen e OshC-ve në procesin e vendimmarrjes politike. Ky është një nivel relativisht i ulët i pjesëmarrjes i cili zakonisht konsiston në ofrimin njëkrahor të informatave nga autoritetet publike, duke mos kërkuar dhe duke mos pritur ndërveprim ose përfshirje të OJQ-ve. Informimi është relevant për të gjithë hapat e procesit të vendimmarrjes. Pa qenë të informuar paraprakisht për planet dhe punën e institucioneve publike, qytetarët nuk mund të marrin pjesë në asnjë fazë të mëvonshme të punës së institucionit përkatës.

Konsultimi është një formë e pjesëmarrjes, ku autoritetet publike u kërkojnë qytetarëve dhe OShC-ve mendimin e tyre rreth një teme të caktuar të politikave ose zhvillimeve. Konsultimi zakonisht nënkupton informimin e qytetarëve dhe OShC-ve nga autoritetet për zhvillimet e ndryshme të politikave dhe kërkesën për komente, qëndrime dhe reagim. Iniciativa dhe temat dalin nga autoritetet publike, e jo nga qytetarët dhe OShC-të.

Dialogu është një proces i vazhdueshëm i konsultimit në mes të autoriteteve publike dhe OShC-ve, i cili ndodh në të gjitha fazat e bërjes dhe zbatimit të politikave, që nga përcaktimi i agjendës e deri te vlerësimi dhe riformulimi i politikës. Dialogu mund të jetë i gjerë apo specifik. Dialogu i gjerë nuk është i lidhur me ndonjë proces specifik të zhvillimit të politikave, por mbetet i përgjithshëm dhe kryesisht synon përcaktimin e agjendës. Dialogu specifik ndërtohet në interesa të përbashkëta për zhvillim të një politike të

	<p>caktuar, ndërsa rezulton me rekomandime dhe veprime konkrete.</p> <p>Partneriteti nënkupton përgjegjësi të përbashkëta në secilin hap të procesit të vendimmarrjes politike në mes të autoriteteve publike dhe OShC-ve, duke filluar nga caktimi i agjendës, draftimi, vendimi dhe zbatimi i ndonjë nisme të politikave. Kjo është edhe forma më e lartë e pjesëmarrjes. Në këtë nivel OShC-të dhe autoritetet publike nisin një bashkëpunim të ngushtë, por duke u siguruar që në të njëjtën kohë OShC-të të vazhdojnë të mbesin të pavarura dhe të kenë të drejtën e fushatave dhe veprimeve pavarësisht nga situata e partneritetit.</p> <p>Të gjitha institucionet publike në Kosovë e kanë obligim kushtetues që të përfshijnë qytetarët në punën e tyre, qoftë në hartim apo zbatim të politikave dhe programeve të tyre. Obligimet më të mëdha i ka niveli komunal, ku secila komunë duhet t'i njoftojë qytetarët mbi "planet ose programet e rëndësishme për interesin publik". Qytetarët e një komune kanë të drejtë për të marrë pjesë në aktivitetet e komunës përkatëse, për të drejtën e peticionit, iniciativës qytetare, referendumit lokal, ndërsa komunat obligohen që të themelojnë komitete konsultative brenda sektorëve, në të cilat duhet të ftohen edhe përfaqësues të OShC-ve. Në nivelin qeveritar, të gjitha aktet qeveritare (përveç vendimeve me karakter administrativ) duhet që paraprakisht të konsultohen me publikun, ndërsa qeveria obligohet që të ofrojë informata të mjaftueshme rreth dokumentit që konsultohet, kohë të mjaftueshme për kontribut, si dhe të raportojë për rezultatet e konsultimit. Për të gjitha ligjet që aprovohen nga Kuvendi i Kosovës mund të organizohen dëgjime publike, ndërsa OShC-të mund të marrin pjesë edhe në takimet e komisioneve parlamentare.</p>
Cili është zotimi?	<p>Të përmirësohen platformat ekzistuese për pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset vendimmarrëse duke ofruar asistencë teknike dhe ngritjen e kapaciteteve për zyrtarët publikë komunalë.</p> <p>Ofrimi i asistencës teknike dhe ngritja e kapaciteteve për zyrtarët publikë për të planifikuar më mirë dhe me efektivitet takimet/konsultimet e tyre me qytetarët si dhe</p>

	<p>ndërgjegjësimin e zyrtarëve publikë për rëndësinë e përfshirjes së të rinjve në procese të tilla. Konkretisht, për të përmbushur zotimin, qeveria do të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ofroj asistencë teknike dhe ngritje kapacitetesh për zyrtarët publikë për të planifikuar më mirë dhe në mënyrë efektive takimet/konsultimet e tyre me qytetarët - Marr parasysh sugjerimet e qytetarëve gjatë dëgjimeve publike dhe të ndjek rekomandimet e dhëna për të inkurajuar pjesëmarrjen e qytetarëve në të ardhmen - Promovoj dhe mirëmbaj platformat dixhitale qeveritare ekzistuese për konsultime publike - Angazhoj të rinjtë në vendimmarrje për të pasur më shumë përfshirje dhe përfaqësim të shqetësimeve publike - Komunikimi i informacionit duhet të bëhet përmes platformave të mediave sociale, faqes zyrtare të komunës, pamfleteve, Radiotelevizionit etj., për informimin më të mirë të qytetarëve.
<p>Si kontribuon zotimi në zgjidhjen e problemit të identifikuar?</p>	<p>Ndërhyrjet që do të ndërmerren për përmbushjen e këtij zotimi kontribuojnë në përmirësimin e angazhimit më të mirë të qytetarëve, rritjen e mbikëqyrjes ekzekutive nga organet komunale dhe qeveritare, shoqëria civile dhe mediat, si dhe funksionimin e mekanizmave mbikëqyrës. Gjithashtu do të përmirësojë efikasitetin, transparencën dhe përfshirjen e publikut në vendime të rëndësishme dhe do të rrisë cilësinë e vendimmarrjes.</p>
<p>Pse është i rëndësishëm zotimi për vlerat e PQH-së?</p>	<p>Forcon të drejtën qytetare për t'u dëgjuar dhe për të marrë pjesë aktive në proceset vendimmarrëse.</p>
<p>Përshkrimi i rezultateve të pritura</p>	<p>Rezultati i pritur i referohet një informacioni të qasshëm dhe të shpërndarë në kohë për publikun. Në këtë mënyrë qytetarët mund të informohen në përputhje me rrethanat dhe do të rritet niveli i përfshirjes në proceset vendimmarrëse.</p>

No	Arritjet	Indikatorët	Bartësi i aktivitetit	Data e fillimit	Data e përfundimit
.					

1.	Krijimi i mekanizmave për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, përkatësisht Udhëzimit Administrativ për Standardet Minimale të Konsultimeve Publike në Komuna.	Numri i qytetarëve dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile që marrin pjesë në dëgjesat/konsultimet publike të organizuara nga autoritetet e nivelit vendor.	Komunat	01/01/2024	01/06/2024
2.	Krijimi i mekanizmave për mbikëqyrjen e zbatimit të Rregullores për standardet minimale për procesin e konsultimit publik, e cila përcakton standardet, parimet dhe procedurat e procesit të konsultimit publik ndërmjet autoriteteve publike dhe palëve të interesit në procesin e politikëbërjes dhe vendimmarrjes.	Numri i qytetarëve dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile që marrin pjesë në dëgjimet/konsultimet publike të organizuara nga autoritetet e nivelit qendror	Të gjitha institucionet publike qendrore	01/07/2024	01/12/2024
3.	Rregullisht organizohen ngjarje për ngritjen e kapacitetit për zyrtarët publikë	Numri i zyrtarëve publikë të trajnuar.	Komunat	01/07/2024	31/08/2024

Zotimi 2: Mbështetja e nismave të shoqërisë civile në ngritjen e vetëdijes përmes fushatave për të parandaluar përhapjen e proceseve gjyqësore strategjike kundër pjesëmarrjes publike (SLAPP).

01/01/2024 – 31/12/2025

Cili është problemi i adresuar nga ky zotim?

Kohët e fundit, në Republikën e Kosovës, ka pasur një rritje shqetësuese të numrit të lëndëve SLAPP (*Proceset gjyqësore Strategjike kundër Pjesëmarrjes Publike*) të sjella në gjykata, të cilat përdoren për të kërcënuar aktivistët e shoqërisë civile për t'i heshtur, censuruar dhe dekurajuar ata që të flasin për interesin publik.

Cili është zotimi?

Përmes këtij zotimi, qeveria synon të konfirmojë qëndrimin e saj kundër përhapjes së padive të tilla përmes organizimit të tryezave dhe konferencave të ndryshme, duke konfirmuar kështu qëndrimin pozitiv

	ndaj zërave kritikë që vijnë nga qytetarët dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile.
Si kontribuon zotimi në zgjidhjen e problemit të identifikuar?	Kundërshtimi i padive të tilla nga qeveria dhe zyrtarët lokalë do të rrisë ndërgjegjësimin e publikut të gjerë për rreziqet e këtyre padive në lidhje me shprehjen e mendimit të lirë dhe të drejtën qytetare për pjesëmarrje publike.
Pse është i rëndësishëm zotimi për vlerat e PQH-së?	Promovimi i transparencës, lirisë individuale për të shprehur një mendim dhe të drejtës për pjesëmarrje publike.
Përshkrimi i rezultateve të pritura	Zëri i Qeverisë kundër SLAPP është evident.

Nr.	Arritjet	Indikatorët	Bartësi i aktivitetit	Data e fillimit	Data e përfundimit
1.	Miratimi i Direktivës së ardhshme të BE-së kundër SLAPP	Direktiva e miratuar	Zyra e Kryeministrit	01/01/2023	01/03/2024
2.	Pjesëmarrja në tryeza/konferenca kundër përhapjes së proceseve gjyqësore strategjike kundër pjesëmarrjes publike	Numri i ngjarjeve në të cilat është marr pjesë	Zyra e Kryeministrit, Ministritë dhe Komunitat	01/01/2024	01/10/2024
3.	Mbështetja e organizatave të shoqërisë civile në fushatat kundër SLAPP	Numri i fushatave të mbështetura	Zyra e Kryeministrit, Ministritë dhe Komunitat	01/10/2024	01/12/2025

Zotimi 3: Krijimi i mekanizmave për ankesat e qytetarëve në lidhje me shërbimet e institucioneve publike	
01/01/2024 – 31/12/2024	
Cili është problemi i adresuar nga ky zotim?	Mekanizmat e ankesave u mundësojnë qytetarëve t'u japin autoriteteve publike komente mbi standardet e shërbimeve që marrin. Këta mekanizma luajnë një rol të rëndësishëm dhe lejojnë zyrtarët publikë dhe të zgjedhur të identifikojnë se ku ofrohen shërbimet publike në mënyrë joefektive dhe/ose joefikase. Kur mekanizma të tillë trajtojnë shpejt ankesat, ato mund të ndihmojnë në krijimin e kushteve për rritjen e besimit mes qytetarëve dhe institucioneve publike. Mekanizma të tillë mund të ndihmojnë gjithashtu qeveritë qendrore dhe

	vendore për të identifikuar ide të reja dhe për të rritur pjesëmarrjen e qytetarëve.
Cili është zotimi?	Dizajnimi dhe lansimi i një platforme, pra një aplikacioni për telefona të mençur që do të mundësonte komunikimin e reagimeve të qytetarëve ndaj institucionit publik.
Si kontribuon zotimi në zgjidhjen e problemit të identifikuar?	Një kanal i krijuar për ankesa do të ketë një ndikim të madh në cilësinë e shërbimeve publike dhe në llogaridhënien e institucioneve. Ai gjithashtu do të shërbejë si një mundësi për zyrtarët e zgjedhur që t'i përshtasin shërbimet e institucionit komunal me nevojat e qytetarëve.
Pse është i rëndësishëm zotimi për vlerat e PQH-së?	Mekanizmat e ankesave mund të rrisin llogaridhënien dhe transparencën e institucioneve publike si dhe të rrisin pjesëmarrjen qytetare.
Përshkrimi i rezultateve të pritura	Krijimi i mekanizmave për ankesat e qytetarëve në lidhje me shërbimet e institucioneve publike.

Nr.	Arritjet	Indikatorët	Bartësi i aktivitetit	Data e fillimit	Data e përfundimit
1.	Krijimi i mjeteve të qëndrueshme (aplikacione për telefonat inteligjentë) që do t'u ofronin qytetarëve mundësinë për të dhënë komentet e tyre në ofrimin e shërbimeve publike.	Funksionalizimi dhe lansimi i aplikacionit	Zyra e Kryeministrit	01/01/2024	01/06/2024
2.	Organizimi i fushatave promovuese për mekanizmin e ankesave që targetojnë të gjithë qytetarët	Numri i fushatave të organizuara	Zyra e Kryeministrit dhe komunat	01/06/2024	31/12/2024
3.	Ngritja e kapaciteteve të stafit përkatës në përdorimin e aplikacionit dhe gjenerimin e të dhënave nga mjete (aplikacioni)	Numri i stafit të trajnuar	Ministritë dhe komunat	01/09/2023	Vazhdon

4. KUNDËR-KORRUPSIONI

Zotimi 1: Sistem plotësisht i hapur i prokurimit publik	
01/01/2024 – 31/08/2025	
Cili është problemi i adresuar nga ky zotim?	Prokurimi publik në Kosovë ka përmirësime të vazhdueshme çdo vit, sidomos tani që

	platforma e e-Prokurimit gjithnjë e më shumë po avancohet. Megjithatë, në pjesët ku ende ka nevojë për faktorin njeri, vërehen çalime. Shkeljet e vazhdueshme të ligjit nga zyrtarët e prokurimit dhe ndëshkimet e pakta po shkaktojnë një situatë ku nuk po arrihet qëllimi i Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), pra që të ketë prokurim efikas. E-prokurimi është një sistem pjesërisht i hapur i Prokurimit Publik.
Cili është zotimi?	Sistem plotësisht i hapur i prokurimit publik dhe kontraktimit të hapur.
Si kontribuon zotimi në zgjidhjen e problemit të identifikuar?	Hapja e të dhënave në lidhje me të gjitha nivelet e prokurimit publik (nga faza para tenderimit, faza e tenderimit dhe faza pas tenderimit e tutje) në një format të lexueshëm nga makineria, e bën prokurimin publik të hapur dhe transparent, në mënyrë që individët ose grupet e caktuara të gëzojnë qasje të lehtë në informacion.
Pse është i rëndësishëm zotimi për vlerat e PQH-së?	Qasja në informacione të lexueshme nga makineritë ka të bëjë me qeverisjen e mirë, çiltërsinë, transparencën dhe llogaridhënien sa i përket shpenzimit të parave publike dhe rritjes së mirëqenies së qytetarëve dhe përmirësimit të shërbimeve publike.
Përshkrimi i rezultateve të pritura	Kontraktimi i hapur

Nr.	Arritjet	Indikatorët	Bartësi i aktivitetit	Data e fillimit	Data e përfundimit
1.	Shqyrtimi i të gjitha mangësive aktuale në prokurimin publik përmes seminareve/grupeve të punës	Problemet ekzistuese janë identifikuar dhe rregulluar	KRRPP, Ministria e Financave	01/01/2024	01/06/2024
2.	Hyrja në fuqi e Ligjit të ri të Prokurimit Publik	Ligji i ri i miratuar	KRRPP, Ministria e Financave	01/06/2023	31/12/2024
3.	Monitorimi i zbatimit të Ligjit të ri për Prokurimin Publik	Miratimi i akteve nënligjore që sigurojnë zbatimin më të mirë të ligjit të ri		01/01/2025	31/12/2025
4.	Zhvillimi i rregullave, mjeteve dhe udhëzimeve të reja në lidhje me zbatimin e një sistemi të hapur të prokurimit elektronik, në ofrimin e informacionit dhe shërbimeve të	Numri i mjeteve dhe udhëzimeve të hartuara	KRRPP, Ministria e Financave	01/09/2023	30/06/2025

lexueshme nga makineritë bazuar në parimet e kontraktimit të hapur.				
---------------------------------------------------------------------	--	--	--	--

Zotimi 2: Rritja e transparencës së institucioneve të rekrutimit për postet e larta shtetërore	
01/09/2023 – 31/08/2025	
Cili është problemi i adresuar nga ky zotim?	Mungesa e transparencës gjatë vlerësimit të kandidatëve për poste të larta shtetërore
Cili është zotimi?	Rritja e transparencës së institucioneve të rekrutimit
Si kontribuon zotimi në zgjidhjen e problemit të identifikuar?	Zhvillimi i proceseve transparente dhe të përgjegjshme të rekrutimit, bazuar në parimin e publicitetit, si dhe duke përfshirë pjesëmarrjen e gjerë të shoqërisë civile
Pse është i rëndësishëm zotimi për vlerat e PQH-së?	Përzgjedhja e personave meritorë dhe kompetentë në institucionet publike, bazuar në parimet e transparencës, llogaridhënies dhe barazisë së kandidatëve, padyshim do të ndikojë në performancën dhe besueshmërinë e institucioneve publike përkatëse.
Përshkrimi i rezultateve të pritura	Është rritur ndjeshmëria dhe ndërgjegjësimi për rëndësinë e proceseve të rekrutimit për postet e larta shtetërore.

Nr.	Arritjet	Indikatorët	Bartësi i aktivitetit	Start Date	End Date
1.	Procedurat për rekrutimin e posteve të larta shtetërore janë të standardizuara dhe të unifikuara	Udhëzues që përcaktojnë procedurat e rekrutimit në mënyrë të standardizuar dhe të unifikuar	Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratë Publike	01/01/2024	30/06/2024
2.	Krijimi dhe funksionalizimi i platformës online për rekrutimi e zyrtarëve posteve të larta shtetërore.	Platforma E-Rekrutimi funksionalizohet.	Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratë Publike	01/01/2024	01/06/2024
1.	Procesi i përzgjedhjes së kandidatëve për poste të larta publike është transparent dhe votimi nga anëtarët e panelit intervistues është publik	Numri i procesverbaleve të publikuara gjatë procesit të intervistimit të kandidatëve	Kuvendi i Republikës së Kosovës / komisionet parlamentare, si dhe institucionet tjera përgjegjëse për zgjedhjen	01/01/2024	31/12/2025

			e pozitive të larta shtetërore; Agjencia Kundër Korrupsion		
2.	Anëtarët e panelit intervistues japin justifikimet dhe arsyetimin për pikët përkatëse për secilin kandidat.	Qasja në raportet e anëtarëve të panelit intervistues	Kuvendi i Republikës së Kosovës / komisionet parlamentare, si dhe institucionet tjera përgjegjëse për zgjedhjen e pozitive të larta shtetërore; Agjencia Kundër Korrupsion	01/01/2023	31/12/2025
3.	Listat e kandidatëve që plotësojnë kriteret formale për poste të larta shtetërore i dorëzohen Agjencisë Kundër Korrupsionit për një opinion ligjor për një konflikt të mundshëm interesi.	Numri i listave të kandidatëve të dorëzuara në AKK	Kuvendi i Republikës së Kosovës / komisionet parlamentare, si dhe institucionet tjera përgjegjëse për zgjedhjen e pozitive të larta shtetërore; Agjencia Kundër Korrupsion	01/01/2023	31/12/2025

Zotimi 3: Rritja e transparencës, llogaridhënies dhe kontrollit të financave të partive politike të regjistruara në Republikën e Kosovës

01/01/2024 – 31/12/2025

Cili është problemi i adresuar nga ky zotim?	Mungesa e transparencës, llogaridhënies dhe kontrollit të financave të partive politike të regjistruara në Republikën e Kosovës.
Cili është zotimi?	Rritja e transparencës, llogaridhënies dhe kontrollit të financave të partive politike të regjistruara në Republikën e Kosovës
Si kontribuon zotimi në zgjidhjen e problemit të identifikuar?	Republika e Kosovës ka bazë ligjore e cila ju mundëson partive politike të regjistruara të kenë fond vjetor publik dhe gjithashtu të financohen nga donacionet e qytetarëve dhe nga personat juridik. Gjithashtu gjatë

	<p>proceseve zgjedhore partitë politike përfitojnë nga fondi publik, donacionet e qytetarëve dhe personave juridik për zhvillimin e kampanjave zgjedhore në nivelin qendror dhe lokal. Edhe pse kjo është e rregulluar me bazë ligjore republika e Kosovës ende nuk ka arritur të fuqizojë mekanizmat për rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe kontrollit të plotë të financave të partive politike. Çdo vit nga buxheti i shtetit ndahen rreth 4 milionë euro për partitë politike të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës.</p>
<p>Pse është i rëndësishëm zotimi për vlerat e PQH-së?</p>	<p>Krijimi i këtyre mekanizmave është në përputhje me vlerat e OGP-së për të promovuar transparencë, llogaridhënie, kontroll efektiv e të rregullt e qasje të qytetarëve në mënyrën e shpenzimit të financave të partive politike në Republikën e Kosovës.</p>
<p>Përshkrimi i rezultateve të pritura</p>	<p>Partitë politike të regjistruara në Republikën e Kosovës janë transparente, llogaridhënëse, të kontrolluara dhe hapura për qytetarët që të kenë qasje në shpenzimin e financave të tyre.</p>

Nr.	Arritjet	Indikatorët	Bartësi i aktivitetit	Start Date	End Date
1.	Rishikimi dhe plotësim ndryshimi i bazës ligjore që promovon transparencën, llogaridhënien dhe kontrollin e financave të partive politike në Republikën e Kosovës.	<ul style="list-style-type: none"> - Rishikimi dhe plotësim ndryshimi i legjislacionit bazë. - Hartimi i legjislacionit sekondar. 	Zyra e Kryeministrit Komisioni Qendror Zgjedhor Shoqëria Civile	01/01/2024	30/06/2024
2.	Digjitalizimi i të hyrave dhe shpenzimeve të financave të partive politike në Republikën e Kosovës. Krijimi dhe funksionalizimi i platformës online për financat e partive politike	Platforma online zhvillohet dhe funksionalizohet.	Zyra e Kryeministrit Komisioni Qendror Zgjedhor Zyra për për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim Agjencia e Shoqërisë së Informacionit	01/06/2024	01/12/2024

			Shoqëria Civile		
3.	Realizimi i fushatës avokuese dhe mbështetja e organizatave të shoqërisë civile dhe mediave për raportim të keqpërdorimeve të mundshme të financave të partive politike nga vet partitë.	Numri i rasteve të raportuara nga qytetarët, organizatat dhe mediat.	Zyra e Kryeministrit Komisioni Qendror Zgjedhor Zyra për për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim Shoqëria Civile Agjencia Kundër Korrupsion	01/01/2025	31/12/2025
4.	Monitorim i shpenzimit të financave të partive politike gjatë ciklit zgjedhor të vitit 2025 në nivelin qendror dhe lokal.	Publikimi i raporteve hulumtuese për shpenzimin e financave të partive politike gjatë ciklit zgjedhor.	Zyra e Kryeministrit Komisioni Qendror Zgjedhor Zyra për Regjistrimin e Partive Politike dhe Certifikim Shoqëria Civile Agjencia Kundër Korrupsion	01/06/2025	31/12/2025